



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Nr. 450/ 1 Prot.

Tiranë, më 01.022024

Lënda: Kthim përgjigje shkresës tuaj datë 22.01.2024

Drejtuar: znj. Ina Zhupa, Deputete e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4, 1001 Tiranë
Av. Franci Nuri
Rruga e Durrësit, Pallati nr. 126, Shkalla 4, Kati 2, Zyra nr.3, Tiranë
Numër Kontakti 0697839115


Në përgjigje të shkresës tuaj datë 22.01.2024, protokolluar pranë Institucionit tonë me nr. 450 prot, datë 22.01.2024, me anë të së cilës kërkonti informacion për Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit.

Bashkëlidhur gjeni vërtetimin historik të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, regjistruar me vendimin nr. 858, datë 22.07.2021.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KANCELAR

Donald XHELILI




REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË
ZYRA E REGJISTRIT TË OJF-VE

Tiranë, më 24.01.2024

VËRTETIM

Me vendimin Nr. 858 datë 22.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar si organizatë jofitimprurëse **Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit**; me seli në Tiranë, “Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, ndërtesa 6, Hyrja 11, ap. 21, 1019 Tiranë; Kohëzgjatja e veprimtarisë së organizatës është për një periudhë kohore e pakufizuar; Themelues Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Albanian – American Development Foundation; Bordi i drejtorëve përbëhet nga Elva Margariti, Martin Mata, Aleksandër Sarapuli, Flonja Borici, Richard Hodges; Drejtor Ekzekutiv Lorenc Bejko; Qëllimi i fondacionit është administrimi indirekt i zonave të trashëgimisë kulturore, nënzonat A3, Parku Kombëtar i Butrintit, pasuri me rendësi universal, identifikuar në kërkesën për shprehje interesi, Marrëveshjen e Bashkëpunimit, si dhe në Marrëveshjen e Administrimit (Pasuria Kulturore). Qëllimi përfshin administrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e Pasurisë Kulturore, sigurimin e aksesit dhe shërbimet për publikun në të, promovimin e saj dhe aktivitetet studimore e kërkimore, si dhe përdorimin, qarkullimin dhe veprimtaritë arkeologjike të Pasurisë Kulturore, duke e menaxhuar dhe zhvilluar atë në mënyrën më të mirë të mundshme duke siguruar mjetet e nevojshme financiare dhe stafin e specializuar, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e saj për të gjithë kohëzgjatjen e administrimit indirekt. Konkretisht objekti i veprimtarisë për arritjen e qëllimit të Fondacionit është si më poshtë vijon: administrimi efikas sipas modelit që përshtatet me mire qëllimit për mbrojtjen dhe zhvillimin e Pasurisë Kulturore etj.

Me vendimin nr. 858/1, datë 25.05.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është vendosur: depozitimin e vendimit nr. 10, datë 23.01.2023 të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit në të cilin është vendosur: Pranimin e dorëheqjes së z. Lorenc Bejko nga pozicioni i drejtorit ekzekutiv të përkohshëm të Fondacionit. Funkcionet e drejtorit ekzekutiv do të ushtrohen bashkërisht nga Kryetari i

Bordit të drejtorëve dhe nënkryetari i Bordit të drejtorëve, në përputhje me nenin 15.3, pika (d), të statutit të Fondacionit, deri në përzgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit ekzekutiv të Fondacionit.

Me vendimin nr. 858/2, datë 05.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është vendosur: Depozitimin e Vendimit Nr.12 datë 03.04.2023, të Bordit të Drejtorëve i cili ka vendosur: 1. Emërimin e z. Carlos Huberto Jhon, në pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv, duke filluar nga 2 maj 2023.

Me vendimin nr. 858/3, datë 25.09.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është vendosur: Bordi Drejtues i Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, me vendimin Nr. 15, datë 21.07.2023 ka vendosur: Miratohet emërimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për një mandat 2 vjeçar si më poshtë: Ministri i Kulturës, Znj. Elva Margariti; Bashkë-drejtori i AADF, z. Martin Mata; Bashkë-drejtori i AADF, z. Aleksandër Sarapuli; Drejtori i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Znj. Klesta Qirici; Eksperti ndërkombëtar, z. Richard Hodges. Ministri i Kulturës, Znj. Elva Margariti rizgjidhet në pozicionin e Kryetarit të Bordit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit për një mandat 2 vjeçar; Bashkë-drejtori i AADF, z. Martin Mata rizgjidhet në pozicionin e nën kryetarit të Bordit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit për një mandat 2 vjeçar.

Ndryshime të mëtejshme nuk ka.

SEKRETARE E REGJISTRIT TË OJF-ve

Besa KORBECI

